

**VENDIM**  
**Nr. 227, datë 26.10.2018**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d”, të nenit 5, pika 1, germa “d”, të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 628, datë 3.10.2018, shoqëria “Ener Trade” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 221, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 prot., datë 11.10.2018. Po ashtu, me shkresën nr. 628/2 prot., datë 16.10.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k.

- Subjekti, me shkresën nr. 628/1 prot., datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar, cituar më sipër.

- Aplikimi i shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 dhe 4.7.1): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**